



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Mr. ... Prof.

Tiranë, më 10.02.2017

LËNDA: Shkresë për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave

DREJTUAR: INSTITUCIONEVE PULIKE TË ARSIMIT TË LARTË _____

Në vijim të kërkesave të përsëritura nga përfaqësues të grupeve të interesit, studentë, familjarë dhe prindër të studentëve “Për përjashtimin nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit për institucionet publike të arsimit të lartë”, ju sqarojmë se:

Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të Vendimit nr. 699, datë 22.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përjashtimin ose reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare, profesionale, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë “master profesional” dhe “master i shkencave”/“master i arteve të bukura” në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014 – 2015”, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, që ndjekin ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si:

- a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
- b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
- c) invalidët;
- ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
- d) jetimët; dh) romët;
- e) ballkano - egjiptianët;
- ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
- f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës;
- gj) të prekurit nga HIV/AIDS.

2. Paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit studentët, që ndjekin ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” ose “Master i Shkencave”/“Master i Arteve të Bukura”, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që vijnë nga shtresat sociale, si:

- a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
- b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
- c) invalidët;
- ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
- d) jetimët; dh) romët;
- e) ballkano - egjiptianët;
- ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;

- f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës;
- gj) të prekurit nga HIV/AIDS.

Në zbatim të pikës 18 të Vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", i ndryshuar me vendim nr. 866, datë 23.10.2015 përcaktohet se: Studentët, të cilët vijnë nga shtresat sociale, sipas përcaktimeve në shtojcën 1/2 bashkëlidhur këtij vendimi, *përrjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit në të gjitha programet e studimeve të ciklit të parë "Bachelor", programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët, të cilët vijnë nga shtresat sociale, sipas përcaktimeve në shtojcën 1/3 bashkëlidhur këtij vendimi, paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në rast se ndjekin ciklin e dytë të studimeve, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë."*

Për sa më sipër të gjitha të drejtat e fituara nga studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë me vendimet e cituara më lart do të vijojnë të përfitohen deri në miratimin e akteve nënligjore konform kërkesave të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Gjithashtu sqarojmë se në zbatim të ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Arsimit dhe Sportit është duke përgatitur dhe miratuar paketën e akteve nënligjore . Kategoritë e studentëve që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë publik për vitin akademik 2016-2017, si personave me aftësi të kufizuar apo me aftësi të veçanta duke përfshirë dhe kategoritë sociale të studentëve të komunitetit romë dhe komunitetit egjiptian, do të jenë pjesë e kategorive të studentëve që përfitojnë nga përjashtimi/ reduktimi i tarifave vjetore të shkollimit sipas kuadrit ligjor ne fuqi.

Për sa më sipër për kategoritë e cituara më lart deri në miratimin e akteve nënligjore, nuk do të kërkohet arkëtimi i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2016-2017.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

